



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

**VENDIM**

Nr. 6 Data 03.10.2017

**Për miratimin e lejes së ujit për prodhim hidroenergjie, burimit ujqor në lumin Shuri i Kuçit, degë e lumit Shushicë, për ndërtimin e hidrocentralit "KUC" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Himarë, qarku Vlorë, subjektit "AGE Kuç" sh.p.k., me administrator Z. Besar Llapashtica.**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujqor"; **V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015**, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

**VENDOSI**

Miratimin e lejes së ujit për prodhim hidroenergjie, burimit ujqor në lumin Shuri i Kuçit, degë e lumit Shushicë, për ndërtimin e hidrocentralit "KUC" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Himarë, qarku Vlorë, subjektit "AGE Kuç" sh.p.k., me administrator Z. Besar Llapashtica me këto të dhëna:

Koordinatat: X4402323; Y4451873; Z 514.50

Prurja mesatare: 1.22 m<sup>3</sup>/sek

Prurja e llogaritur: 1.50 m<sup>3</sup>/sek

Prurja e ekologjike: 0.28 m<sup>3</sup>/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1930 kW**

Afati i lejes 5 vjet

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËRGJEGJËSIA.B.U “VJOSË”**

**Ilir PROFKA**



**KRYETAR I K.B.U “VJOSË”**

**Etjona HOXHA**

